

Tiranë, më 05.12.2022

### VENDIM ASAMBLEJE

U mbledh sot asambleja e shoqërisë Klima Teknika TB2 shpk pajisur me Nuis (Nipt)-K49322506W me rend dite;

- Njohja e investimit/huase së dhënë për shoqërine nga Arben Paja .

Bazuar në legjislacionin e mëposhtëm;

- Ligji Nr.9723,datë 03.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" I ndryshuar.
- Ligji Nr.9901,datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", I ndryshuar.

Prej themelimit të shoqërisë Klimateknika TB2 shtetasi Arben Paja është kontribues në mënyrë të pandërprerë në veprimtarinë tregëtare dhe arritjet e kësaj shoqërie.

Për sa më sipër pas rakordimit të shumave të Kreditimit në vite nga Arben Paja në formën e huave për Investime në shoqërinë Klimateknika TB2, në përfundim të mbledhjes Asamblesë së Ortakut të vetëm datë 05.12.2022 u Vendos;

Unë Petrit Paja, ortak I shoqërisë KLIMA TEKNIKA TB2 SHPK me Nipt K49322506W, njoh investimin/huanë e dhënë nga vëllai im Arben Paja në vlerën 24,000,000 Lekë, të cilën e kam përdorur për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë.

Sa më sipër vendosëm që vlerën e sipërcituar në formën e huasë të mos e kthejmë mbrapsht , por ta njoh si ortak të shoqërisë vëllain tim Arben Paja me kontribut në Kapitalin Themeltar të shoqërisë Klimateknika TB2 në shumën 24,000,000 lekë.

Si përfundim, kapitali I shoqërisë është I njëjtë 48.000.000 lekë,ndërsa ortakëria është si më poshtë;

Petrit Paja, zoterues i 50 % të kuotave me kontribut në para në shumën 24,000,000 lekë

Arben Paja, zoterues i 50 % të kuotave me kontribut në para në shumën 24,000,000 lekë

ORTAKËT:

Petrit Paja

Arben Paja

KLIMATEKNIKA T.B.2 sh.p.k.  
Air Conditioning & Ventilation  
Nipt: K49322506W  
Gjirokastër Albania